

Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

KËTË JAVË:

- Albin Kurti merr pjesë në homazhet në Srebrenicë
- Kërkojmë heqjen e urdhrit që ndalon hyrjen e Dejona Mihalit në Kosovë
- Denoncim publik ndaj dyshes zhvatesë Rrahim Pacollit dhe Gani Thaçit

Albin Kurti merr pjesë në homazhet në Srebrenicë

Javës që shkoi, deputeti i VETËVENDOSJE!-s, z. Albin Kurti, mori pjesë në shënimin e 21 vjetorit të masakrave dhe gjenocidit në Srebrenicë, ku për pak ditë ushtria dhe vullnetarët serbë patën vrarë së paku 8.327 boshnjakë.

Z.Kurti u ftua nga Lëvizja e Nënave të Enklavave të Srebrenicës dhe Zhepës, përkatësisht nga kryetarja znj. Munira Subashiq, si dhe nga kryetari i Shoqatës së Viktimave dhe Dëshmitarëve të Gjenocidit, z. Murat Tahiroviq. Sivjet, organizatorët boshnjakë i kishin shpallur të padëshirueshëm në Srebrenicë qeveritarët nga Serbia.



Në Potočari të Srebrenicës janë varrosur deri më tani 6.377 viktima dhe aty sot u varrosën edhe 121 të tjerë. z. Kurti mori pjesë në ceremoninë mortore, vizitoi shoqatat e familjarëve dhe bëri nderime te monumenti pranë varrezave e vendosi lule të freskëta në kujtim të të vrarëve. Ai shprehu solidaritetin e tij me të afërmit e viktimave dhe popullin boshnjak.

21 vite më parë në Bosnjë e Hercegovinë ndodhi krimi më monstruoze që ka parë Evropa pas Holokaustit.

Në Srebrenicë u vranë e u masakruan mbi 8 mijë njerëz të pafajshëm. As pas 21 vitesh Serbia nuk e ka pranuar fajin për gjenocidin që ka kryer si shtet. Republika Srpska, ky projekt i krijuar nga gjenocidi edhe sot është kërcënim për viktima të reja. Kështu ndodh kur marrëveshjet e paqes bazohen në raporte forcash, dhe jo në vendosje të drejtësisë.

Projekti shovinist serb që ka shkaktuar luftërat në ish Jugosllavi është ende aty. Ai po vazhdon të tolerohet në emër të interesa-

ve gjeopolitike e ruajtjes së stabilitetit. Por, historia ka treguar se rreziqet më të mëdha për paqen janë konservizimi i padrejtësisë e formave të ndryshme të diskriminimit.

Kërkojmë heqjen e urdhrit që ndalon hyrjen e Dejona Mihalit në Kosovë

Më 18 korrik 2016, rreth orës 07:30 është ndaluar të hyjë në Kosovë Dejona Mihali, Koordinatore e Komiteteve dhe anëtare e kryesisë të Lëvizjes VETËVENDOSJE!



Dejona Mihali është mbajtur për disa orë në kufi, dhe më pas është kthyer në Shqipëri, pasi i është komunikuar një urdher për ndalim të hyrjes në territorin e Kosovës, pa afat.

Policia kufitare i ka marrë direktivat drejtpërdrejt nga Ministria e Brendshme, dhe komunikimi është kryer në prani të Dejona Mihalit. Është për t'u vënë në dukje se urdhri për ndalimin e hyrjes në territorin e Kosovës është lëshuar në shkurt, por prej asaj kohe e deri sot Dejona Mihali nuk është vënë kurrë në dijeni për ekzistencën e këtij urdhri, as zyrtarisht e as në ndonjë mënyrë tjetër.

Ky vendim arbitrar është marrë pa u bazuar në asnjë ngjarje faktike, në asnjë ligj dhe pa asnjë vendim gjyqësor. Ky arbitraritet i pushtetit të Thaçit, Mustafës dhe i Veselit po e bën Kosovën një vend pa të drejta demokratike e civile, po e shpërfaq si një tirani despotësh të vegjël, që të vetmin funksion e kanë servilizmin ndaj ndërkombëtarëve, Serbisë e mafias.

Ndalimi i Dejona Mihalit i shtohet deportimit të Boiken Abazit dhe Arbër Zaimit, si një fushatë sistematike që qeveria e Kosovës e ka ndërmarrë ndaj veprimtarëve të Lëvizjes që janë nga Shqipëria. Reagimet e zbehta të qeverisë së Shqipërisë na bëjnë të pandehim se kjo fushatë kriminale e arbitrare është e koordinuar mes dy qeverive.

Në vizionin e despotëve bashkimi kombëtar është bashkim i forcave të regresit, i mafias, i dallaveraxhinjve, i dhunës, i krimit e i servilizmit. Në vizionin tonë bashkimi kombëtar është bashkim i popullit, i prodhu-

Nr. 471, 21 korrik 2016

esve, i qytetarëve të ndërgjegjshëm, i kulturës, i dinjitetit e mbi të gjitha bashkim kombëtar i idealit.

Ai kufi ka qenë armik i idealistëve e i dëshmorëve që na e prunë lirinë, ai kufi është dhe armiku jonë. Ai kufi ka qenë i ashpër ndaj atyre që e deshën këtë vend, ai kufi është sot i ashpër ndaj nesh. Atë kufi e mbrojtën me gjak ushtarët e Titos e të Rankoviçit, e të njëjtët e mbrojnë dhe sot.

Kërkojmë heqjen e menjëhershme të urdhrit të ndalimit për Dejona Mihalit dhe ndalje të persekutimit të aktivistëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! nga Republika e Shqipërisë, përndryshe kjo qeveri do të mbajë një vulë të madhe turpi, e do ta paguajë rëndë përballë historisë.

Denoncim publik ndaj dyshes zhvatesë Rrahim Pacollit dhe Gani Thaçit

Përmes një komunikate për shtyp, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Zvicër denoncoi publikisht zhvatjen që po i bëhet mërgatës shqiptare nga Kosova.

Ashtu siç ndodhë përherë, në prag të pushimeve verore, zyrtarët sundimtarë, nuk harrojnë, që nën emrin e «polisave të sigurimit», të vazhdojnë grabitjet e tyre për mërgimtarët ende pa hyrë brenda kufirit të Kosovës.

Kësaj radhe, rolin e përkrahësit zyrtar të institucioneve të Kosovës e mori vetë kryeparlamentari Kadri Veseli. Këtë javë, ai priti në konsultë Kryetarin e Këshillit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Rrahim Pacollin që së bashku me Gani Thaçin, përbëjnë dyshen grabitqare të mërgimtarëve në pikat kufitare të Kosovës.

Deri më tani, nga llogaritë e thjeshta del se nga kjo dyshe, nën kontrollin dhe për egon e tyre të pangopur, janë grumbulluar mbi 120 milionë euro. Në mungesë të transparencës dhe llogaridhënës, para institucioneve, as para opinionit të Kosovës, është përdorur në kundërshtim të çdo rregulli dhe ligji të një shteti të drejtë.

Ngritja e zërit dhe denoncimi para prokurorit të shtetit të bëhet urgjent dhe pa mëdyshje. Dyshja, Rrahim Pacolli dhe Gani Thaçi, të bëhen objekt i hetimit dhe të dërgohen para gjykatës.

Kjo detyrë, pa hezitim, i takon dhe duhet ta marrë përsipër Prokurori i Republikës së Kosovës Aleksandër Lumezi, përfundon shkresa e Vetëvendosjes. përfundon shkresa e kësaj Qendre.